

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 04-10.11.2024

Janë testuar gjithsej 187 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=185) është shënuar një rritje prej 1,1%.

Pozitive janë 4 raste, 2 më pak nga java e kaluar. Përqindja e rasteve pozitive sillet nga 0,0% deri më 7,1%, mesatarisht 2,2%.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 04-10.11.2024

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
04.11.2024	46	0	0,0%
05.11.2024	36	1	2,8%
06.11.2024	33	0	0,0%
07.11.2024	28	2	7,1%
08.11.2024	20	0	0,0%
09.11.2024	19	1	5,3%
10.11.2024	5	0	0,0%
Gjithsej	187	4	mesatarja 2,2%

Gjatë javës së kaluar raste janë regjistruar në 2 qytete. Numri më i madh është regjistruar në Shkup (n=3; 75,0%).

Raste të reja janë regjistruar tek grupmosha mbi 30 vjet.

Sipas algoritmit të ri, si të shëruar konsiderohen 5 persona që kanë qenë të shtruar në spital ose në trajtim shtëpiak.

Gjatë javës së kaluar (04-10.11.2024), nuk është raportuar rast i vdekjes si pasojë e COVID-19.

GJENDJA KUMULATIVE ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Gjatë vitit 2024, deri më 10.11.2024, janë regjistruar gjithsej 1.737 raste me COVID-19. Në muajin tetor të vitit 2024 (56) regjistrohet një rënie prej 80,6% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2024, deri më 10.11.2024, janë testuar gjithsej 12.392 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen teste molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

VLERËSIMI I RREZIKUT

Pas një periudhe aktiviteti shumë të ulët, detektohet një rritje e aktivitetit të SARS-CoV-2 brenda kontinentit evropian, përfshirë edhe në R. e Maqedonisë së Veriut.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 11.11.2024

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>